



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Marçela Shehu).- shtyrë nga mbledhja 02.11.2023¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare)* |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës. Filloi në orën 15:22 mbledhja “online”.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte EWMI.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore *znj. Marçela Shehu*). (shtyrë nga mbledhja 02.11.2023)

Shënim: Pjesa hyrëse e këtij procesverballi lidhet me çeljen e mbledhjes plenare me prezencën edhe me të tretët, nga ku më pas, siç edhe do të relatohet nga zoti Rusi, për shkak të ndryshimit të kronologjisë së trajtimit të çështjeve të rendit të ditës, për çështjet të cilat trajtohen vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit, gjë për të cilën anëtarët bien dakord që të trajtohen në fillim, audio do të ndërpritet për të tretët.

Prezenca e anëtarëve ka qenë e tillë siç do të relatohet nga zoti Rusi në çeljen e kësaj mbledhjeje. Më tej, pjesëmarrja e tyre ndryshon lidhur me prezencën e tyre në sallë apo “online” në çështje të caktuara, gjë që do të evidentohet rast pas rasti në procesverballin përkatës.

Ilir Rusi: Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, sot është mbledhja e radhës e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 06.12.2023.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami është në një angazhim institucional. Kështu që mbledhja e ditës së sotme do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu zonja Plaku është me një angazhim po institucional (Konferencë Ndërkombëtare).

Ndërsa zoti Kurushi do të jetë prezent në këtë mbledhje “online”.

Anëtarët e tjerë janë prezent në sallë së bashku me mua, kështu që mbledhjen e deklaroj të hapur për shkak edhe të krijimit të kuorumit të nevojshëm.

Duke iu referuar rendit të ditës, sipas natyrës së çështjeve, kemi çështje të cilat trajtohen me dyer të hapura, pra për publikun dhe kemi edhe çështje të cilat për shkak të karakterit, trajtohen me dyer të mbyllura.

Keni ndonjë diskutim mbi kronologjinë e rendit të ditës?

Po zonja Luli, fjala për ju!

Fatmira Luli: Atëherë, z. Zëvendëskryetar!

Meqenëse unë kam kandidaten për kancelare në detyrë znj. {...} dhe kemi dhe kemi dhe çështjen tjetër që bëhet me dyer të mbyllura, kancelarin e Elbasanit, propozoj që këto të zhvillohen në fillim, çështjet me dyer të mbyllura, meqenëse personat kanë ardhur dhe janë prezent dhe mbledhja jonë sot mund të zgjasë shumë për shkak të tematikës që kemi. Propozoj që të parat të shqyrtohen ato me dyer të mbyllura, pastaj të kalojmë në çështjet me dyer të hapura.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka ndonjë diskutim tjetër mbi kronologjinë?

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, jeni dakord me propozimin e znj. Luli, që fillimisht të trajtohen çështjet me dyer të mbyllura dhe pastaj çështjet të cilat janë të hapura për publikun?

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, kjo mbledhje do vazhdojë fillimisht me trajtimin e çështjeve të mbyllura, kështu që ftoj stafin që të largohet, ata të cilët nuk mund të jenë prezent në këtë moment në mbledhje, dhe njëkohësisht të bëhet shkëputja e komunikimit me të tretët “online”.

(Pas trajtimit të çështjeve me dyer të mbyllura të cilat u trajtuan në fillim të mbledhjes si çështje e parë, e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë që lidhen me kualifikimin/skualifikimin e kandidatëve, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024 znj. {...}, {...}, {...} dhe {...}, si dhe me kualifikimin apo jo të kancelarëve në detyrë z. {...} dhe {...}, krijohet mundësia e lidhjes me të tretët nëpërmjet platformës “online” si dhe vijon rendi me çështjet e radhës, në këtë rast me çështjen nr. 7 sipas kronologjisë së re. Gjithashtu edhe prezenca e anëtarëve ndryshon për sa i përket pjesëmarrjes në sallë apo nëpërmjet platformës, ku bashkë me zotin Kurushi, online futet edhe znj. Ukperaj.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje po vazhdojmë me çështjet e hapura. Ka ndonjë diskutim për çështjet e hapura?

Po zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Do kërkoja mirëkuptimin e kolegëve që çështjet në të cilat jam unë relatores të trajtohen fillimisht, konkretisht është çështja nr. 1 dhe çështja nr. 5 (zonja Shehu i referohet rendit të shpërndarë fillimisht në mbledhje), pasi për arsye të një impenjimi më duhet të largohem më pas nga mbledhja. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime të tjera?

Po votojmë propozimin e zonjës Shehu.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, vazhdojmë këtë mbledhje me këtë kronologji të përcaktuar tashmë të këtij rendi dite në lidhje me çështjet e hapura. Vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores znj. Shehu. Kjo çështje është shtyrë nga mbledhja e datës 12.11.2023.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Siç jeni në dijeni, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” me të cilin ju keni disa kohë në fakt që jeni njohur. Gjithsesi, unë do të bëj një përmbledhje të shkurtër të relacionit.

I. Detyrimi Ligjor për Nxjerrjen e Aktit

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, ka vijuar procesin për miratimin e Udhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatave me publikun dhe median.

Akti që i paraqitet sot për miratim mbledhjes plenare bazohet në nenet 22, 23, 147, pika 1 dhe 147, pika 1, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 91, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit “ Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, nenet 5, 46 dhe 50 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, kodet e procedurës civile e penale, ligjin për gjykatat administrative, ligjin “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Akti ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave të informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase. Miratimi i këtyre rregullave synon gjithashtu standardizimin e marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, si dhe rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

Përgatitja e këtij akti përmbush detyrimin ligjor që buron nga parashikimet e nenit 91 të ligjit “Për qeverisjen”, i cili përcakton shprehimisht në pikën 1, shkronja “ç”, se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesin standard të shtypit. Po ashtu, projektvendimi përmbush detyrimet ligjore që burojnë nga nenet 5 dhe 46 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht: për të siguruar aksesin në gjykata, trajtimin e barabartë të çdo personi, pa asnjë diskriminim, si dhe funksionimin e gjykatave në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase; për ofrimin e shërbimeve në respekt të parimit të së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

Akti objekt shqyrtimi është gjithashtu në përputhje me Synimin 5 të Planit Strategjik të KLGJ 2022- 2024 “Zbatimi dhe Përmirësimi i Strategjive për Komunikimin e Jashtëm”, ku midis të tjerash, KLGJ angazhohet për:

- Rritjen e transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie proaktive, transparente e informuese;

- Fuqizimi i ndërveprimit të KLGJ-së me gjykatat për zbatimin e planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor miratuar nga KLGJ.

Hartimi i këtij akti ka ardhur si rezultat i një pune intensive të Grupit të Punës, ngritur me vendim të KLGJ-së, i cili është mbështetur nga Projektet e Asistencës teknike si EURALIUS V, ai i zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje - Perëndim (EWMI) i financuar nga INL, si dhe nga INFOÇIP me mbështetjen e veçantë të Ambasadës Holandeze në Shqipëri. Gjej rastin në fakt që t'i falënderoj edhe këtu në mbledhje plenare si ekspertët e EURALIUS-it që kanë punuar, grupin e punës, gjyqtarët, ekspertët e Institutit të Menaxhimit Lindje – Perëndim, Valbonën dhe {...}, që na asistojnë vazhdimisht që nga krijimi i Këshillit, INFOÇIP-in dhe z. {...}, si dhe në mënyrë të veçantë Ambasadën Holandeze që kanë dhënë një ndihmë dhe një kontribut shumë të rëndësishëm si dhe ka marrë përsipër edhe organizimin e të gjitha aktiviteteve konsultuese që janë realizuar në kuadër të procesit të konsultimit të këtij akti.

Ky udhëzues merr në konsideratë parime dhe rekomandime të cilat janë pjesë e instrumenteve ndërkombëtare si Rekomandimi nr.(2010)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, apo Rekomandimi nr.(2003)13 në ofrimin e informacioneve përmes mediave në lidhje me rastet gjyqësore penale.

Marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe medias janë në evoluim të vazhdueshëm edhe në vendet e Bashkimit Evropian. Në thelb ky zhvillim ka të bëjë me çështjet e profesionalizmit nga ana e magistratëve dhe gazetarëve dhe kërkon modele të reja të trajnimit profesional dhe zhvillimit të formave të përshtatshme të ndërveprimit. Në këtë drejtim, vlen të kujtojmë paragrafin 19 të Rekomandimit (2010) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, në temën e pavarësisë, efektivitetit dhe përgjegjësisë e gjyqtarëve, miratuar më 17 nëntor 2010: “Procedurat dhe çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë janë me interes publik. Megjithatë, e drejta për informim në lidhje me çështjet gjyqësore duhet të ushtrohet duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga pavarësia e gjyqësorit. Zëdhënësit e gjykatave ose themelimi i shërbimeve të shtypit dhe të komunikimit janë në përgjegjësinë e gjykatave ose nën këshillat gjyqësorë apo nën autoritete të tjera të pavarura është i inkurajuar. Gjyqtarët duhet të jenë të përmbytur në marrëdhëniet e tyre me mediat.”.

Gjithashtu, sjellim në vëmendje se edhe paragrafi 14 (Qasja në drejtësi dhe transparencë) e Magna Karta të gjyqtarëve, e miratuar më 17 nëntor 2010 nga Këshilli

Këshillimor i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), nënvizon se: “Drejtësia duhet të jetë transparente dhe informacioni duhet të publikohet në funksionimin e sistemit gjyqësor.”.

Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin, në raportin "Besimi publik dhe imazhi i drejtësisë - Raporti 2017-2018", miratuar në Lisbonë më 1 qershor 2018, nxori rekomandimet mbi vendosjen e strategjive alternative të komunikimit, pasi duke u fokusuar në rëndësinë e komunikimit të gjyqësorit dhe rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, vëzhgoi se komunikimi i efektshëm i sistemit gjyqësor krijon mundësinë për këtë sistem që të shpjegojë rolin dhe veprimtarinë e tij, duke zhvilluar në këtë mënyrë besimin dhe mirëkuptimin që ai (sistemi gjyqësor) është i paanshëm dhe i drejtë. Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin, në këtë raport zhvillon gjerësisht perspektivën e komunikimit në fushën e drejtësisë dhe sugjeron miratimin e planeve kombëtare të veprimit, kontrole periodike të nivelit të besimit, të trajnimeve profesionale specifike (për kryetarët e gjykatave, etj.), zhvillimin e udhëzimeve për marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe medias. Veçanërisht, ndër të tjera rekomandon emërimin si “zëdhënës” të gjyqtarëve apo prokurorëve me specifikim trajnimit e komunikimit dhe ngritjen e një “departamenti të specializuar” që punëson profesionistë në komunikim nën drejtimin e “gjyqtarit/prokurorit të medias”.

Udhëzuesi gjithashtu reflekton rekomandimet e miratuara nga CEPEJ në vitin 2018, ku midis të tjerash, evidentohen edhe qëllimet e komunikimit gjyqësor si vijon:

- të informojë për veprimtari konkrete të sistemit të drejtësisë, në raste të veçanta (procedime);
- të pohojë rolin e drejtësisë në shoqëri;
- të afirmojë pavarësinë e institucioneve gjyqësore, veçanërisht kur vihet në pikëpyetje;
- të promovojë respektin për institucionet gjyqësore dhe përfaqësuesit e tyre;
- të përforcojë ose të rivendosë besimin e qytetarëve në institucionet gjyqësore;
- të mbajë qëndrime publike për çështjet me interes për drejtësinë dhe shoqërinë, nëse rrethanat e justifikojnë atë;
- të përmirësojë të kuptuarit e ligjeve nga publiku;
- në përgjithësi, për të forcuar imazhin e drejtësisë.

Pa cenuar parimin kushtetues mbi të drejtën e informimit, nga i cili është i

motivuar udhëzuesi standard i medias dhe që është njohja së jashtmi e veprimtarisë gjyqësore dhe arsyet e saj, perspektiva e këtij dokumenti është ofrimi i një orientimi drejt rregullave të sjelljes që lejojnë komunikimin dhe dhënien e informacionit brenda një kohe efektive, kjo dhe në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Kjo gjykatë në jurisprudencën e saj, në balancim të lirisë së shprehjes me vlerat e tjera themelore të shpallura në Konventë, ka specifikuar se rëndësia publike e çështjes nuk mund të eliminojë mbrojtjen e jetës private, që i përket individëve. Sipas praktikës së GJEDNJ, për sa i përket publikimit të paligjshëm të informacioneve (lajme sekrete ose konfidenciale, informacione të fushës rreptësishtë private), ekziston një detyrë shtetërore për të marrë masa organizative dhe të trajnimit të personelit për të parandaluar rrezikun e publikimit të informacionit. Veçanërisht në procesin penal, e drejta për të informuar publikun dhe e drejta e publikut për të marrë informacione mund të gjenden në kundërshtim të interesave që kanë rëndësi të njëjtë dhe të cilat mbrohen me sekretin hetimor. Ato interesa janë autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit, efikasiteti i hetimeve penale dhe e drejta e palës në prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen e jetës private.

Në lidhje me konsultimin e aktit.

Udhëzuesi është konsultuar gjerësisht në disa tryeza të mbajtura gjatë muajve mars dhe prill 2023 me gjyqtarët e medias, gazetarët, me pjesëmarrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu, gjatë muajve qershor – korrik, projekt-udhëzuesi është konsultuar në rrugë elektronike edhe me Organizata të Shoqërisë Civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë. Sugjerimet dhe rekomandimet e marra janë vlerësuar nga grupi i punës dhe reflektuar për aq sa ka qenë e mundur brenda objektit të këtij Udhëzuesi.

Akti gjithashtu është konsultuar edhe me të gjithë Këshillat e të gjitha gjykatave.

Udhëzuesi standard përbën një dokument, që synon të reflektojë dinamikat e komunikimit midis gjykatave, medias dhe publikut. Ky udhëzues frymëzohet nga bindja që transparenca dhe kuptueshmëria e gjyqësorit nuk bie ndesh me natyrën e përmbajtur të funksionit të magjistratit, pasi e interpretuar drejt kjo qasje rrit besimin e qytetarëve tek drejtësia dhe shteti i së drejtës, forcon pavarësinë e gjyqësorit dhe, në përgjithësi, autoritetin e gjykatave. Transparenca dhe kuptueshmëria e veprimtarisë gjyqësore janë vlera, të cilat burojnë nga karakteri demokratik i sistemit ligjor dhe janë të lidhura me

parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë të gjyqësorit si dhe, me një konceptim modern, për përgjegjësinë e gjyqtarëve.

Tërësia e rregullave që përmban ky udhëzues garantojnë parime si akses i barabartë në gjykata, karakteri publik i procesit gjyqësor, hapja maksimale e veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësinë dhe të dhënat personale, reputacionin si dhe prezumimin e pafajësisë. Po ashtu, ky udhëzues synon krijimin e mekanizmave që komunikimi i gjykatës me publikun dhe median të jetë i besueshëm, transparent, objektiv, i paanshëm, i balancuar, i matur, koherent si dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas legjislacionit në fuqi. Nisur nga natyra standarde e rregullave, media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet gazetarëve, duke evituar krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privileguara me gazetarë të caktuar, pa personalizuar informacionet dhe pa shprehur opinione personale. Në lidhje me komunikimin me publikun, udhëzuesi udhëhiqet nga parime të cilat tashme janë konsoliduar nga zbatimi i ligjit për të Drejtën e Informimit, sipas të cilit: “Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik që administrohet nga gjykata pa u detyruar të shpjegojë motivet.”

Udhëzuesi gjithashtu udhëhiqet nga parimi se raportimi në media, përfshirë komentimin e proceseve gjyqësore, kontribuon në publicitetin e tyre dhe është plotësisht në përputhje me nenin 6 të Konventës sipas së cilës seancat duhet të jenë publike. Në çdo rast nuk duhet të tejkalohen kufijtë e vendosur në interes të administrimit të mirë të drejtësisë, veçanërisht në drejtim të garantimit të prezumimit të pafajësisë.

Në lidhje me shpjegimin e aktit unë nuk do të ndalem në mënyrë të detajuar. Mund të them që udhëzuesi është i organizuar në 5 (pesë) kapituj, të cilët në mënyrë të përmbledhur përmbajnë rregullime si vijon:

Kapitulli I, titullohet “Dispozita të përgjithshme”, përfshin 2 nene të cilat përcaktojnë qëllimin dhe parimet mbi të cilat bazohet marrëdhënia midis gjykatave dhe median dhe publikun.

Kapitulli II, titullohet “Shërbimi i marrëdhënies me publikun dhe median dhe metodat e komunikimit”, përmban 5 nene.

Kapitulli III – ka lidhje me aksesin në vendimet gjyqësore dhe të dhënat e tjera të

gjykatës, përbëhet nga 4 nene të cilët rregullojnë parimet e dhënies së informacionit mbi dokumentet zyrtare të gjykatës, të dhënat pa kërkesë, informacionin për vendimet gjyqësore, dhe informacionin me kërkesë.

Kapitulli IV – parashikon rregulla specifike për informimin e medias mbi procesin gjyqësor, dhe përbëhet nga 2 nene.

Në fund kemi zbatimin e aktit.

Akti (drafti) është vënë në dispozicion, besoj jeni njohur.

Shoqërohet me projektvendimin përkatës i cili ka vetëm një pikë. Në pikën 1 i propozohet Këshillit të miratojë “Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime?

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Ndjesë nëse do duhet të bëj një parashtrim të gjatë për të arsyetuar në lidhje edhe me shtyrjen e seancës të cilën e kam kërkuar për t’u njohur me praktikën ndërkombëtare në lidhje me prezencën e medias (sepse këtu do fokusohem më së shumti) në një seancë gjyqësore. Më duhet të falënderoj dhe vlerësoj punën jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të çmuar natyrisht që ka kryer anëtarja e KLGJ-së për shtypin, znj. Shehu, e cila falë këtij kontributi ka arritur të institucionalizojë marrëdhëniet me median nëpërmjet këtij udhëzimi, paraqitjes së këtij projekti për t’u miratuar nga ana e Këshillit, që synon për hir të transparencës së ofrojë një garanci medias në pjesëmarrjen e tyre gjatë seancave gjyqësore; por në mënyrë të veçantë, njëkohësisht edhe kontributin që ka dhënë në mbrojtjen e figurës së gjyqtarëve, gjithmonë në ato raste kur gjyqtarët janë konsumuar produktet e atyre mediave të cilët kanë spekuluar me detyrën e tyre. Ndërkohë me këtë grup shoqëror profesionistësh i cili ka rezultuar i vështirë përpara marrjes së mandatit nga kjo anëtare, vetë strukturat e brendshme të këtij grupi profesionistësh kanë konstatuar dhe kanë diagnostikuar sëmundje të cilat natyrisht ndikojnë për keq edhe në një seancë gjyqësore.

Më lejoni të paraqes shkurtimisht se çfarë kanë diagnostikuar në organizimin e tyre Këshilli Shqiptar i Medias, i cili ka bërë një vlerësim të shkurtër të panoramës mediatike në Shqipëri. Versioni i fundit i Kodit të Etikës sot daton në vitin 2006 por nuk zbatohet rigorozisht, nuk merret në referencë ose nuk respektohet. Shkeljet e vazhdueshme të Kodit janë kthyer në standard ndërsa vëmendja editoriale ndaj këtyre shkeljeve është ulur, dobësuar ose tjetërsuar. Mediat vazhdojnë të publikojnë fakte dhe emra të paverifikuar në dy burime. Këto publikime shpesh i kanë në qendër individë të pafajshëm të cilët për shkak të papërgjegjshmërisë së botimeve të tilla dëmtohen profesionalisht ose në jetën e tyre private ose sociale. Megjithëse Kodi i Etikës shpreh qartë se në raste të tilla mediat duhet të korrigjojnë impaktin e publikimeve të tilla, kjo nuk ndodh kurrë, duke lënë publikun të zhgënjyer nga mediat apo gazetarë të caktuar. Aktualisht kontrolli i brendshëm redaksional është në nivelin më të ulët të mundshëm. Gazetarëve rrallë herë u kërkohet të verifikojnë dy ose tre burime apo fakte thuajse nuk ka asnjë vëmendje apo ndjeshmëri ndaj atyre që dëmtohen nga publikime të tilla. Humbja e publikut ka detyruar mediat të bëhen të varur nga të fuqishmit apo të pasurit, të cilët nga ana tjetër blejnë “të vërtetën”. Niveli i komunikimit me publikun është sipërfaqësor dhe asnjëherë i bazuar në etikën gazetareske.

Pra pikërisht në ndërveprimin me këtë komunitet profesionistësh pala e munduar duhet të jetë gjithmonë gjykata e cila për shkak të natyrës që ka dhe detyrimit që ka për të mos iu përgjigjur ndaj çdo lloj provokimi, sepse këtë detyrim e ka nga normat më të larta të drejtësisë qoftë të drejtës së brendshme apo asaj ndërkombëtare apo për vetë madhësinë e funksionit gjyqësor, tipare këto të konstatuara në disa prej vendimeve të GJEDNJ-së siç është rasti i “Lavents kundër Letonisë” apo “Buscemi kundër Italisë” na bëjnë që detyrimisht këtë marrëdhënie ta institucionalizojmë me anë të këtij udhëzimi. Gjithsesi në zona të caktuara apo në pjesë të caktuara të këtij udhëzimi kam verifikuar mediatizim të seancave gjyqësore, që normalisht edhe pse bashkohem me opinionin e një nga autorët më influent të Gjykatës së Lartë amerikane dhe promotori i krahut liberal për afërsinë me median William Brennan i cili ka pohuar se jo gjithmonë mediatizimi i gjykatës apo paragjykimi i pakontrolluar mediatik i një procesi gjyqësor mund të komprometojë proceset gjyqësore me procesin e rregullt ligjor. Kjo sepse qendër e figurës në këtë seancë është gjithmonë gjyqtari i cili do duhet të dijë jo vetëm t’i ruhet

provokimit por edhe të vendosë disa kufij të cilët janë të nevojshëm për të ruajtur standardin e një procesi të rregullt ligjor.

Për të ardhur në temë, që mos e zgjasë më tepër, i vetmi ndryshim që unë kërkoj t'i nënshtrohet dhe ndoshta mund të marrë edhe miratimin tuaj, është pika 4 e nenit 13 ku thjesht midis fjalëve ose pas fjalës “të raportojë”, pra pika 4 është: “4. Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, lejohet të raportojë...”, këtu bëhet një ndërprerje, “... vetëm pasi më parë ka marrë autorizimin e kryetarit të seancës përmes mesazheve të shkruara apo pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike. Në çdo rast, këto pajisje duhet të përdoren pa zë.”.

Pra ajo që unë dua të evidentoj është që kryetari i seancës vazhdon në çdo situatë të jetë ai që do drejtojë median, ai që do të vlerësojë që interesi publik legjitim nuk duhet ngatërruar asnjëherë me informacionin që është interesant për publikun sepse janë koncepte krejt të ndryshme dhe në këtë kontekst mund të të ofrojë dhe për sa kohë për atë mundësi që ka për të administruar një seancë gjyqësore, mund të ofrojë një garanci të tillë.

Më duhet edhe të evidentoj se si e kanë zgjidhur, meqenëse u shty për t'u njohur me praktikën ndërkombëtare, se si e kanë zgjidhur çështjen e ndjekjes së çështjeve gjyqësore edhe vende të tjera demokratike, për të mos thënë që janë më të avancuara se ne në këtë aspekt. Po e nis nga faqja e internetit të Kosovës ku Gjykata Speciale për Krimet e Luftës, në prezantimet që bën apo në ofrimin që bën për të ndjekur seancat gjyqësore nga mediat, parashikon që gazetarët mund t'i ndjekin seancat publike nga qendrat për mediat me vonesë në transmetim ose drejtpërdrejt nga galeria për publikun. Pra nuk shikon të nevojshëm prezencën e gazetarit në një seancë gjyqësore, pavarësisht se këtu interesi publik është jashtëzakonisht i lartë, për të mos thënë që është edhe ndërkombëtar.

Natyrisht, përveç kësaj unë do të sillja edhe shembujt e gjykatave greke ku në seancat gjyqësore të kryera ndaj eksponentëve të një organizate terroriste “17 Nëntori”, përfaqësuesit e medias i kishte akomoduar, të themi, në një zyrë të posaçme, të pajisur me audio dhe video, ku ata ndiqnin seancën gjyqësore.

Për të mos shkuar pastaj tek procesi i Italisë në '92-'93 ku në një gjykim, në një nga gjykatat, të themi, bunker të Italisë, me prezencën e 300 të pandehurve, 600

avokatëve dhe 400 përfaqësues të medias, këta të fundit u akomoduan përsëri në të njëjtën zonë.

Pra solla gjithë këtë rezyme për të thënë që jo detyrimisht transparencja është e barabartë me prezencën e medias në një seancë gjyqësore, pasi mund të organizohen edhe forma të tjera të infrastrukturës që ata të mund të ndjekin seancën.

Gjithsesi, përfundimisht, i vetmi propozim, duke parë dhe kushtet e infrastrukturës gjyqësore që ka Shqipëria, i vetmi propozim që sjell për momentin për këtë akt është ajo e pikës 4, neni 13, ku përfaqësuesi mund të raportojë nëpërmjet mesazheve vetëm pasi më parë ka marrë autorizimin e kryetarit të seancës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Po! Ka diskutime?

Po zonja Shehu!

Marçela Shehu: Fillimisht falënderoj zotin Toro për të gjithë vlerësimin që bëri në fillim të fjalës së tij për punën që është bërë në lidhje me forcimin e marrëdhënieve midis Këshillit dhe medias dhe në përgjithësi sistemi gjyqësor me median.

Në lidhje me rezervën që ka zoti Toro për pikën 4 të nenit 13 të udhëzuesit, ku aktualisht parashikohet se “Përfaqësuesi i medias gjatë seancës lejohet të raportojë vetëm përmes mesazheve të shkruara nga pajisjet telefonike dhe/ose kompjuterike. Në çdo rast, këto pajisje duhet të përdoren pa zë.”, shqetësimi që ngre zoti Toro që përdorimi i tyre duhet të bëhet vetëm nëse lejohet nga gjykata unë vlerësoj se është ezauruar dhe është dhënë zgjidhje në pikën 5 të këtij neni, që duhet ta citoj. Në pikën 5 të këtij neni parashikohet se:

“5. Nëse përdorimi i pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike, apo pajisjeve të tjera, pengon administrimin e duhur të drejtësisë, ose rendin dhe rregullin e procesit gjyqësor, gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues, me urdhër, mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e tyre gjatë seancës.”

Pra në çdo rast do të jetë gjykata, gjyqtari apo trupi gjykues, i cili nëse do të konstatojë që ka përfaqësues të medias që keqpërdorin këto pajisje, pra nuk i përdorin për qëllimin për të cilin janë lejuar, atëherë mund të marrin masa për t’i penalizuar, pra për ta

kufizuar të drejtën e tyre për përdorimin e tyre. Kështu që mendoj që zgjidhja i është dhënë. Pastaj, le ta vlerësojë Këshilli cila është më e përshtatshme.

Unë dua të theksoj se në çdo rast është gjykata, është gjyqtari i çështjes, trupi gjykues i cili menaxhon situatën në sallën e gjykimit dhe i cili nëse konstaton që, qoftë media apo qoftë individë të caktuar, prishin rendin apo qetësinë apo pengojnë administrimin e duhur të procesit, është gjykata përgjegjëse, kompetente për të marrë të gjitha masat e nevojshme.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime apo propozime të tjera?

Meqenëse nuk ka diskutime apo propozime të tjera...

Brikena Ukperaj: Më fal zoti Zëvendëskryetar, mund të bëj një pyetje për të sqaruar pak atë çka relatoi Marçela dhe Albani?

Ilir Rusi: Patjetër zonja Ukperaj, se unë kam disa herë që them nëse keni diskutime apo jo. Kështu që, është pjesë e diskutimit edhe pyetja juaj.

Brikena Ukperaj: Atëherë, për ta kuptuar pikën 4 dhe pikën 5 të nenit 13, nënkupton parashikimi një leje paraprake nga ana e gjyqtarit ose gjykatës/trupit gjykues apo vetëm nëse konstatohet që ky regjistrim që ka filluar dëmton administrimin, atëherë gjykata mundet ta kufizojë përdorimin? Pra zoti Toro ka parasysh që gazetari apo kushdo që është në sallë nga ana e medias duhet të marrë një autorizim paraprak nga ana e gjykatës apo mund të futet, të bëjë regjistrimin dhe nëse gjykata konstaton që dëmtohet administrimi, atëherë e kufizon? Për ta ndarë këtë gjë.

Alban Toro: Briken, po më pyet mua apo?

Brikena Ukperaj: Edhe ty, se nuk të kuptova në formulimin e pikës 4.

Ilir Rusi: Fjala për zotin Toro!

Alban Toro: Po! Atëherë, ajo që unë evidentova është që ai paraprakisht duhet të marri leje. Në rast se pastaj krijon burim shqetësimi, ai është i vetmi person që do t'ia revokojë lejen. Kjo ishte e gjitha.

Brikena Ukperaj: Po! Po!

Ndërsa, parashikimi Marçela, në qoftë se nuk gabohem është që ai e fillon dhe vetëm nëse dëmtohet administrimi, atëherë gjykata mund ta kufizojë.

Ilir Rusi: Po zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Propozimi i grupit të punës është ai që keni përpara tek drafti. Gazetari lejohet të ketë celular me vete apo mjete të tjera kompjuterike, të cilat në çdo rast mund t'i përdori pa zë. Ky është propozimi i grupit të punës, që do të thotë, ai vetëm mund të dërgojë mesazhe të caktuara. Nëse i përdor jo në formën e duhur, atëherë gjykata mund të marri masa që mos të lejojë gazetarin për përdorimin.

Brikena Ukperaj: Pra propozimi i grupit të punës është që nuk ka nevojë për një leje paraprake për ta kryer këtë veprim?

Marçela Shehu: Po! Sepse është menduar që është edhe mjet pune për gazetarin. Sigurisht gazetari si përçues i lajmit tek publiku, ka edhe interesin që lajmi të përçohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe sigurisht pa cenuar rregullat e procesit.

Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera, propozime?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime dhe propozime të tjera, vazhdojmë fillimisht me votimin e propozimit të bërë nga zoti Toro në lidhje me nenin 13, pika 4, duke u formuluar me atë përmbajtje të cilën mbledhja e theksoi.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundra.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin e z. Toro.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e z. Toro.

(Miratohet propozimi i z. Toro me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Atëherë, vazhdojmë me miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, sipas tekstit bashkëlidhur, por duke marrë në konsideratë ndryshimin që do të ndodhë në nenin 13, pika 4 sipas propozimit të bërë nga zoti Toro, i cili u miratua me shumicë votash nga anëtarët prezent në këtë mbledhje, prezent në sallë dhe “online”.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Atëherë, unë përpara se të shpreh arsyet e opinionit tim pro këtij aktit udhëzues të komunikimit të gjykatës me mediat dhe publikun, do të më lejoni të shpreh edhe konsideratën më të lartë për punën e zonjës Shehu përgjatë këtyre muajve, për të na paraqitur këtë udhëzues, këtë draft përfundimtar. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë “Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median” sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*::

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare)* |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte EWMI.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Sipas kronologjisë së rendit të ditës të miratuar nga ne, vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej, fjalën relatores *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni Disiplinor parashtron përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor çështjen lidhur me procedurën e zhvillimit të shortit për caktimin e relatorit për procedimin disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} dhe mbi vijueshmërinë e procedurës së shqyrtimit të procedimit.

Siç jeni në dijeni, Ministri i Drejtësisë me shkresat nr. {...} prot., datë 01.10.2012 dhe nr. {...} prot., datë 26.10.2012, ka paraqitur kërkesat para ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për nisjen e procedimit disiplinor të gjyqtarit {...} dhe i ka propozuar Këshillit të vendosë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor, Ministri i Drejtësisë me kërkesën nr. {...} prot., datë 23.01.2013, si dhe me kërkesën nr. {...} prot, datë 10.07.2013, ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 304, datë 14.02.2013, si dhe me vendimin nr. 354, datë 19.07.2013 ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së Ministrisë të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit {...} deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatat më të larta.

Sa sipër, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u verifikua nëse aktualisht ekzistonin ende shkaqet, bazuar në të cilat ishte pezulluar procedimi disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Nga verifikimet e bëra, rezulton se çështja për shkak të së cilës ishte vendosur pezullimi i shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, ka përfunduar së shqyrtuari në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nuk ka pengesa ligjore për të vijuar me shqyrtimin e procedimit disiplinor.

Në kushtet kur tashmë shkaku i pezullimit të shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor, konsideruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimet e tij nr. {...}, datë 14.02.2013 dhe nr. {...}, datë 19.07.2013, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Këshilli u vlerësua se janë kushtet e shfuqizimit të vendimeve të pezullimit. Gjithashtu, me rënien e shkakut të pezullimit nuk ekziston asnjë shkak që të pengojë shqyrtimin e kërkesave për procedim disiplinor. Ndaj, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e tij nr. 702, datë 30.11.2023 ka vendosur: “1. Shfuqizimin e vendimeve nr. {...}, datë 14.02.2013 dhe nr. {...}, datë 19.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”. 2. Vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit dhe dërgimin e akteve

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Ky vendim i është komunikuar magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kushtet kur rezulton se vendimi për vijimin e procedimit i është komunikuar magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe në kushtet kur ndodhemi para një procedurë individuale administrative në Këshill, në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016, Komisioni Disiplinor vlerëson se nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen tre anëtarët e përhershëm të tij: znj. Shehu, z. Hado dhe z. Rusi, në referim të nenit 16 të vendimit nr. 316 datë 14.09.2020 të Këshillit Për miratimin e Rregullores për Procedurat Disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor ku përcaktohet se: “Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë”.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se do duhet të procedohet dhe me caktimin e datës së seancës për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, duke konsideruar se ka qenë një procedim tashmë i filluar nga ish-KLD-ja.

Nga sa u parashtrua, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, si dhe caktimin e datës së seancës për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

Projektvendimi i paraqitur përmban tre pika:

Në pikën e parë parashikohet caktimi i anëtarit.

Në pikën e dytë caktimi i datës së zhvillimit të seancës.

Në pikën tre parashikohet që vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë dhe z. {...}.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftohet administrata të hedhë shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Marçela Shehu, z. Ilir Rusi dhe z. Ridvan Hado.

Procedura e përzgjedhjes:

Relator përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Ilir Rusi: E falenderojmë administratën.

Tashmë është caktuar relatori me short.

Zonja Shehu, në lidhje me datën e seancës?

Marçela Shehu: Atëherë, pasi është konsultuar, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare se data e seancës dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, të jetë data 7 dhjetor.

Për orën, duke pasur parasysh axhendën, ndoshta mund ta lëmë si pikë të parë të rendit të ditës, në ora 11:00.

Atëherë propozoj datën 7, ora 11:00.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime në lidhje me hedhjen e shortit, caktimin e relatorit, propozimin për datën e seancës dëgjimore dhe orën?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projekt-aktit duke reflektuar edhe të dhënat që rezultuan nga shorti dhe nga propozimi i zonjës Shehu në lidhje me datën dhe orën e kësaj seance dëgjimore.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin me short të relatorit për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ilir Rusi, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

2. Caktimin e datës 7 dhjetor 2023, ora 11.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit, z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare)* |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare)* |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 8.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala dhe Oltta Lolo, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Fatmira Luli*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë këtë mbledhje plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Zonja Shehu u largua për shkak të një impenjimi që kishte. Kështu që mbledhja vazhdon me anëtarë prezent në sallë dhe “online”. (*Edhe zonja Rupa u largua nga salla dhe u fut “online”, bashkë me anëtarët znj. Ukperaj dhe z. Kurushi të cilët ishin “online”.*)

Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores *znj. Luli*.

Fatmira Luli: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90, pika 1/b, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, është organi kompetent për publikimin dhe shpalljen e konkurrimit të hapur për vendet e lira, në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 59, i ligjit nr. 98/2016 ka përcaktuar që: “Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, është Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

Për sa me sipër, me vendimin nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njërive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, janë krijuar njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit, në tërë gjykatat e apelit siç ishin para miratimit të hartës gjyqësore.

Me vendimin nr. 586, datë 20.11.2020 të KLGJ-së “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit” u shpallën vendet vakante në pozicionin e ndihmësit në të tëra gjykatat e apelit.

Këto vakanca u përmbushën përkohësisht nga të diplomuarit ndihmës ligjorë në vitet 2019-2020 (8 pozicione) dhe nga ndihmësit ligjorë të gjykatave administrative të shkallës së parë (9 pozicione).

Gjithashtu, me vendimin nr. 214, datë 16.06.2022 të KLGJ-së “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit” u shpallën vendet vakante në Gjykatën e Apelit Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, të tre ndihmësve ligjorë të tjerë të diplomuar rishtazi.

Këto vakanca u përmbushën në mënyrë të përhershme nga të diplomuarit ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020-2021.

Referuar VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave" dhe vendimit nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm”, nga data 01.02.2023 ndihmësit ligjorë pranë Njërive të Shërbimit Ligjor në Gjykatat e Apelit ushtrojnë funksionin si ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm.

Në këto kushte, në bazë të informacioneve të disponuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ushtrojnë detyrën e ndihmësit ligjor, pranë gjykatave të apelit, një total prej 31 (tridhjetë e një) ndihmës ligjorë.

Pra, aktualisht, në njësitë e shërbimit ligjor të gjykatave të apelit janë të emëruar në mënyrë të përhershme ose përkohësisht 31 (tridhjetë e një) ndihmës ligjorë, nga të cilët 17 (shtatëmbëdhjetë) prej tyre janë në proces rivlerësimi kalimtar prandaj janë të përkohshëm dhe 8 (tetë) prej tyre kanë përfunduar formimin fillestar dhe për 6 (gjashtë) prej tyre ka përfunduar procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe janë emëruar në shërbimi civil gjyqësor, ndërsa për 2 (dy) prej tyre është në pritje përfundimi i procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me qëllim që të përfundojë procesi i emërimit në shërbimin civil gjyqësor.

Ndërsa 3 (tre) nga kandidatët për ndihmës kanë përfunduar formimin dhe për to ka përfunduar edhe procesi i verifikimit.

Ndër 3 (tre) prej tyre ka përfunduar formimin fillestar, 2 (dy) kandidatë të cilët janë emëruar. Ka ngelur në proces për t'u emëruar vetëm 1 (një) ndihmëse e cila ka përfunduar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës me qëllim që të përfundojë procesi i emërimit në shërbimin civil.

Detajimi i pozicioneve të ndihmësve aktualisht është i tillë:

Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm: ka strukturë 32 ndihmës, organika në fakt është 20, vende vakante 12.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka në strukturë 6 pas miratimit të hartës gjyqësore, 3 organika në fakt dhe 3 vakanca.

Gjykata Administrative e Apelit ka në strukturë 13 pas miratimit të hartës gjyqësore, 8 organika në fakt dhe vende vakante 5.

Në vitin 2023 është diplomuar Znj. {...} e cila është ndihmëse ligjore me 83.37 pikë.

Kandidatja, në zbatim të ligjit ka paraqitur kërkesën për emërim dhe trajtim financiar.

Me vendimin nr. 704, datë 30.11.2023 Këshilli ka vendosur:

“Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit, e cila ka kaluar me sukses programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2022-2023.”.

Nga informacioni që disponon aktualisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore,

rezulton se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, kanë numër më të madh pozicione vakante dhe nevoja më të mëdha për caktimin e ndihmësve nisur nga numri i gjyqtarëve që shqyrtojnë.

Më konkretisht:

Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm ka 37.853 çështje në shqyrtim; Gjykata Administrative e Apelit – 22.693; Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 33 çështje në shqyrtim.

Në këto kushte, propozohet shpallja e 2 (dy) vendeve vakante të pozicionit të ndihmësit ligjor pranë gjykatave të apelit, si më poshtë:

- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të përgjithshëm 1 (një) pozicion ndihmës ligjor;

- Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit 1 (një) pozicion ndihmës ligjor.

Për këtë është bërë edhe projektvendimi i cili përcakton në pikën 1 shpalljen e 2 vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë: Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm - 1 (një) pozicion ndihmës ligjor dhe në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit -1 (një) pozicion ndihmës ligjor.

Pika 2 e vendimit: Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil gjyqësor sipas dispozitave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Shpalljen e 2 (dy) vende vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:

Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm - 1 (një) pozicion ndihmës ligjor;

Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit -1 (një) pozicion ndihmës ligjor;

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil gjyqësor sipas dispozitave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magjistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 04.12.2023).⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare)* |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare)* |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 8.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magjistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 04.12.2023).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me një pikë tjetër të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi pagesën e trajtimit financiar të magjistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Kjo çështje është shtyrë nga mbledhja plenare e datës 04.12.2023. Për më tej fjalën z. Haxhiu për të na azhurnuar me të dhënat të cilat ka marrë këto ditë.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit!

I nderuar zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Në vijim të mbledhjes së kaluar, në të cilën na u la detyrë të plotësojmë informacionin në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Juridike. Ky informacion u mblodh dhe u konstatua që ndryshimi ligjor i cituar nga zonja Ukperaj nuk ka ndryshuar atë periudhën njëmuajore, afati që i lihet Këshillit të Lartë Gjyqësor për verifikimin e figurës dhe pasurisë së magistratëve të rinj të cilët presin të emërohen dhe të caktohen në pozicionet e tyre.

Po kështu, vendimet gjyqësore gjatë viteve buxhetore të kaluara kanë konsistuar në vendimmarrjen e gjykatave administrative për pagesën e periudhës së magistratëve të rinj nga data 1 korrik e mbrapa, përveç bëhet një përjashtim për vitin buxhetor 2020, Gjykata Administrative ka caktuar, ka vendosur pagesën e magistratëve nga 1 gushti deri në momentin e caktimit të tyre në pozicionin në gjykatat përkatëse.

Kështu që në rastin konkret, të gjithë paditë, për vitin buxhetor në vazhdim, të gjitha paditë të cilat janë ngritur (magjistratët e rinj), të gjithë kërkojnë në paditë e tyre trajtimin financiar nga data 1 korrik deri në caktimin e tyre në pozicionet përkatëse në gjykata.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Brikena Ukperaj: Po! Zoti Rusi, mundem?

Ilir Rusi: Po zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Atëherë, në vijim të diskutimit që kam bërë mbledhjen e kaluar. Së pari, dua të theksoj që të gjitha vendimet gjyqësore që na janë vënë në dispozicion bashkëlidhur praktikës nuk janë vendime gjyqësore të formës së prerë. Janë vendime të ekzekutueshme, janë dhënë me ekzekutim të përkohshëm, por nuk janë vendime gjyqësore të formës së prerë për arsye se janë ankimuar në gjykatën e apelit. Së dyti, dua

të theksoj edhe faktin që, në vendimet gjyqësore, në pjesën arsyetuese, ky lloj trajtimi është konsideruar si një dëm që të diplomuarve iu shkaktohet për shkak të përgjegjësisë jashtëkontraktore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Dhe po në këto vendime gjyqësore është cituar që kjo përgjegjësi vjen për shkak të mungesës së dilijencës ose mosveprimit të Këshillit përtej afatit 30-ditor të parashikuar në ligj, dhe ky arsyetim, në një nga vendimet gjyqësore përputhet edhe me dispozitivin e vendimit, ku e drejta e trajtimit financiar iu është njohur nga data 1 gusht, jo nga momenti i diplomimit sepse neni 35 i ligjit parashikon që Këshilli ka të drejtën që brenda një afati njëmuor të emërojë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve. Pra parashikimi njëmuor, afati 30-ditor, është afat në dobi të Këshillit, për të mbyllur procedurën e verifikimit dhe po brenda këtij afati njëmuor, duhet të emërojë të diplomuarin si magjistrat. Në këtë kuptim unë mendoj që nuk ka vend që brenda këtij afati njëmuor ne të parashikojmë trajtim financiar për kandidatin për magjistrat sepse kjo gjë nuk parashikohet në ligj dhe e dyta sepse këtu nuk ka filluar asnjë mosveprim nga ana e Këshillit, përkundrazi, brenda këtij afati 30-ditor ne veprojmë për të mbyllur procedurat e verifikimit. Është afat që na i ka vendosur ligji.

Lidhur me pjesën tjetër të parashikuar (se me sa relatoi zoti Haxhiu, nuk shikoj që është bërë ndonjë ndryshim në projektvendimin e hartuar), në pikën 1 të dispozitivit është parashikuar që trajtimi financiar të fillojë nga data e diplomimit. Unë nuk jam dakord që ky trajtim duhet të fillojë nga data e diplomimit. Kandidatët për gjyqtarë sivjet duhet të jenë diplomuar, shpallja duhet të jetë diku tek 27 qershor, nëse nuk gabohem, dhe deri në në fund, 27 korrik, ne kemi pasur të drejtën për të mbyllur procedurat. Pra 30 ditë kemi qenë brenda afatit ligjor.

Për të vijuar pastaj më tej dhe për të qenë koherent me të drejtën që kanë parashikuar gjykatat, duhet që ky trajtim financiar të fillojë nga data 1 gusht, jo deri në momentin e caktimit, por deri në momentin e emërimit si gjyqtar, për arsye sepse paga është element që lidhet me statusin e gjyqtarit dhe pavarësisht se kur caktohet, ai e merr që nga momenti i emërimit. Unë nuk e di dhe nuk jam në dijeni se si janë paguar gjyqtarët e emëruar. Zoti Haxhiu mund të na e thotë. Janë paguar që në momentin e emërimit apo janë paguar që në momentin e caktimit në pozicion (për vijueshmërinë)? Nëse nuk e kanë marrë pagesën nga momenti i emërimit, dakord që ta marrin deri në momentin e caktimit, por paga është element që lidhet me statusin dhe duhet t'iu ketë

filluar nga momenti i emërimit të tyre.

Megjithatë, kam edhe një rezervë tjetër, sepse unë nuk e di se si do shkojnë procedurat gjyqësore në gjykatën e apelit për këto çështje, të cilat vetë Këshilli i ka ankimuar dhe nuk kemi një vendim gjyqësor nga një gjykatë më e lartë për t'u shprehur lidhur me bazueshmërinë ose jo në ligj të tyre. Në eventualitetin që ne miratojmë këtë vendim sot, praktikisht duhet të heqim dorë nga të gjitha ankimet që kemi bërë ndaj këtyre vendimeve gjyqësore.

Unë kam përgatitur edhe një formulim që mendoj që është më në përputhje me ligjin, edhe me praktikën e gjykatave, për trajtimin financiar.

Ilir Rusi: Zonja Ukperaj, zoti Haxhiu kërkon edhe një herë t'ia perifrasoni në mënyrë më sintetike pyetjen përkatëse.

Brikena Ukperaj: Atëherë, pagimi i magistratëve të rinj të emëruar dhe caktuar në pozicion nga ana e Këshillit në vitin 2023, kur ka filluar nga gjykatat, nga dita e emërimit apo nga dita e caktimit në pozicion?

Xhevdet Haxhiu: Nga data e caktimit në pozicion.

Brikena Ukperaj: Jo nga data e emërimit?

Xhevdet Haxhiu: Jo! Nga informacioni që kemi, nga data e caktimit sepse atëherë janë paraqitur në gjykatë. Sepse gjykatat nuk kanë pasur magistratin e emëruar në gjykatë, s'kanë si ta paguajnë më përpara në rastin konkret. Se gjyqtarët ishin të emëruar por ishin të pacaktuar në pozicionet e tyre, dhe fondi prandaj u shpërnda pas caktimit të tyre në pozicione, nëpër gjykatat respektive. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Dakord.

Atëherë, si datë fillimi unë propozoj që të jetë data 01.08.2023 dhe jo data e diplomimit, me arsyet që thashë, sipas nenit 35 të ligjit "Për statusin", Këshilli ka një afat njëmuor për të bërë verifikimet dhe për të përfunduar verifikimet e pasurisë dhe figurës

dhe për të bërë kualifikimet e magistratëve dhe emërimin e tyre (brenda korrikut thotë ligji); edhe për një arsye tjetër, sepse mund të ndodhë që në këto dy javë pas diplomimit kandidati të mos kërkojë të caktohet në pozicion atë vit. Nuk ka kuptim që ne ta njohim këtë si një të drejtë që ata e kanë të fituar me ligj. Por edhe për diçka tjetër. Do kemi kandidatë të viteve të ardhshme. Në qoftë se ne do miratojmë këtë vendim sot që nga data e diplomimit e në vijim, atëherë duhet çdo vit që magistratëve, muajin korrik t’ua njohim si trajtim financiar. Ndërkohë që, vendimet e gjykatave lidhen me faktin e mungesës së dilijencës së organit, pra lidhen me mosveprimin e organit mbas afatit 30-ditor të parashikuar në ligj.

Për këtë arsye them edhe një herë që trajtimi të përfshijë periudhën 01.08.2023 (dhe meqenëse zoti Haxhiu e saktësoi që është bërë pagesa nga data e caktimit) dhe të vijojë deri në momentin e caktimit të tyre.

Ndërkohë që kam edhe diçka tjetër lidhur me formulimin. Në projekt-akt është përdorur “miratimi i pagesës së trajtimit financiar”, terminologjia “pagesë e trajtimit financiar” për mua nuk është korrekte. Mund të themi thjesht “trajtimin financiar të magistratëve”.

Ta lexoj formulimin që kemi përgatitur dhe pastaj ta vlerësojnë anëtarët.

Ilir Rusi: Po zonja Ukperaj, vazhdoni!

Brikena Ukperaj: Atëherë, propozimi është: Në titullin e projektvendimit të hiqet fjala “pagesën e”, pra të mos titullohet “mbi pagesën e trajtimit financiar”, por të titullohet “Mbi trajtimin financiar të magistratëve, profili gjyqtar, të diplomuar në vitin akademik 2022 – 2023”. Dhe dispozitivi të përfshijë urdhërimin e trajtimit financiar të magistratëve, pra vendosi: “Trajtimin financiar të magistratëve, profili gjyqtar, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, në formën e pagesës mujore ekuivalente me pagën bruto fillestare të magistratit, duke filluar nga data 01.08.2023 deri në momentin e caktimit të tyre në pozicion”. Pastaj vijon pika 2 siç është në formulim.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zoti Haxhiu, fjala për ju!

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Desha vetëm, pa replikuar fare për argumentimin ligjor të zonjës Ukperaj, desha të shtoj diçka. Në vlerësimin tim, bazuar dhe në memon dhe në informacionin mbi të cilin është bërë relacioni pranë Komisionit të Administrimit të Buxhetit, përgatitur nga Drejtoria Juridike, arsyeja e paraqitjes së kësaj çështjeje për shqyrtim dhe miratim në Komision dhe nga Komisioni për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare ka të bëjë me faktin e objektit të kërkesë padive të ngritur nga magjistratët e rinj ndaj KLGJ-së. siç e citova, kërkesa e tyre konsiston në trajtimin financiar nga momenti i diplomimit që koïncidon me datën 1 korrik, deri në momentin e caktimit të tyre në pozicion në gjykatat respektive.

Marrja e këtij vendimi nuk sjell asgjë të re. Vazhdojnë përsëri gjyqet, do vazhdojnë përsëri shpenzimet gjyqësore, do vazhdojnë interesat gjyqësore në rastet kur i kanë kërkuar ose jo, kështu që në vlerësimin tim.. Unë kaq kisha. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Edhe unë nuk do replikoj zoti Haxhiu. Por qëllimi ynë është që të zbatojmë në mënyrë korrekte ligjin. Nuk mund të parashikoj se çfarë vendimi mund të marrë gjykata, por ama unë kam katër vendime gjyqësore bashkangjitur praktikës. Vendimi nr. 2602, 27.10.2020 ka njohur të drejtën e trajtimit financiar duke filluar nga data 01.08.2020 me këtë arsytim që unë ju thashë, pra që brenda afatit 30-ditor organi është në të drejtën e vet ligjore për të kryer veprime, që ne i kryejmë. Vendimi 842, i datës 26.03.2021, në pjesën e dispozitivit, gjykata në këtë rast ka vendosur nga data 1 korrik, por ama në pjesën e arsytimit citon: Palët e paditura, KLGJ dhe KLP, kanë pasur detyrimin të marrin vendim për emërimin ose refuzimin e emërimit të të diplomuarve brenda një muaji nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, konkretisht data 31.07.2020. Tejkalimi i këtij afati pa një vendimmarrje prej palëve të paditura, pavarësisht shkaqeve të parashtruara më lart, konsiderohet si mosveprim administrativ në kuptim të ligjit [...] etj., etj.

Pra moskryerja e veprimeve tej afatit 30-ditor është konsideruar nga gjykata.

Në vijim, gjykata vazhdon: “Gjykata vlerëson se mungesa e trajtimit financiar për

paditësit gjatë fazës së ndërmjetme deri në emërimin e tyre në pozicion përtej afatit njëmuor nga diplomimi është trajtim jodinjitoz dhe joligjor.”.

Pra në pjesën arsyetuese të gjitha gjykatat e konsiderojnë që kjo e drejtë e kandidatëve për gjyqtarë në atë kohë (tashmë ne i kemi gjyqtarë të emëruar) vjen për shkak të dilijencës së organit përtej afatit 30-ditor. Nëse ne do t’ i kishim emëruar brenda muajit korrik të gjithë magistratët, do të ngrinin padi për të marrë pagën e muajit korrik? Të njëjtën gjë kemi bërë edhe me një vit paraardhës ku ne kemi bërë emërimet brenda muajit korrik. Ky është diskutimi që kam.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zonja Luli!

Fatmira Luli: Unë mendoj që afati që duhet të fillojë kjo pagesë është nga momenti që kandidati për magistrat fiton statusin dhe ai status është në datën e emërimit të tij. Data 1 gusht mund të ndryshojë me datat e diplomimit. Ndërsa, emërimi i magistratit (kandidatit) në pozicionin e gjyqtarit fiton statusin, nga ky moment duhet të lidhet pagesa. Kështu që gjykoj që të mos lidhet me data por të lidhet me veprimin. Nga momenti i emërimit duhet të fillojë pagesa deri në momentin...

Brikena Ukperaj: Fatmira, ka diçka. Këtu ka një dallim. Ky trajtim financiar që ne japim tani me këtë projektvendim, nuk është pagë. Unë jam dakord me ty për sa i përket elementit pagë. Paga e gjyqtarit fillon nga momenti i fitimit të statusit, që është data e emërimit. Pavarësisht se për dy-tre ditë ose për një javë bëhet caktimi i tij në pozicion. Këtu bëhet fjalë për trajtimin financiar të kandidatëve për magistratë, të cilët për shkak se Këshilli nuk ka mbaruar procedurat e verifikimit brenda 30 ditëve, ka një periudhë kohe që as nuk mund të punojnë dhe as nuk mund të paguhen. Tani, qëndrimet e gjykatave kanë qenë të tilla që kandidatët për gjyqtarë duhet të vijojnë të paguhen, në formën e një dëmshpërblimi, kanë thënë gjykatat, për shkak të një përgjegjësie jashtëkontraktore që ka lindur për organin publik (në këtë rast KLGJ), të fillojnë të paguhen nga data 1 korrik (disa), nga data 1 gusht (disa). Ky është ndryshimi. Në qoftë se ne do themi për këtë periudhën para emërimit ata nuk mund të marrin pagesë, nuk kemi

më objekt diskutimi sot.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Zoti Hado!

Ridvan Hado: Unë jam dakord me propozimin që trajtimi financiar i magjistratëve të sapoemëruar të bëhet nga data 1 korrik e në vijim. Në argument të kësaj mund të them se më parë kjo periudhë me ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës” ishte e zgjidhur, bëhet pagesa për periudhën që ngeleshin të paemëruar. Në kohën e mëparshme emërimi dhe caktimi bëhej në një dhe ishte e zgjidhur me ligj. Megjithatë, po t’i shikosh të gjithë dispozitat ligjore që merren me problemin në fjalë, në korrelacion të çojnë që duhet në mënyrë të pandërprerë ato kandidatët që janë fillimisht, që përfshihen në Shkollën e Magjistraturës, pastaj të diplomuarit, vazhdojnë detyrën e tyre. Në kuptimin që... dhe është referuar që në vitin e parë, në vitin e dytë, në vitin e tretë, për të qenë të paanshëm dhe për të pasur mundësi, të gjithë kandidatët për magjistratë që vazhdojnë Shkollën e Magjistraturës (kandidatët fitues pra), paguhen me 30, 40 dhe 50%, dhe deri në 30 qershor... Një pyetje që lindi në seancën e kaluar: Pse ato janë diplomuar në datë 27 apo në 13? - nuk e mbaj mend. Po sepse deri në fund të 30 qershorit ato paguhen nga Shkolla e Magjistraturës. Në tërësinë e saj bie që ka marrë përsipër të drejta shteti i paguan dhe ndërkohë kanë detyrime kandidatët që mos merren me veprimtari fitimprurëse. Ndërkohë, nga data 1 korrik e në vijim ato nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër në të gjithë këtë kohën bosh.

Nga ana tjetër, afati njëmuor është që na kondicionin ne që të zgjidhim problemin, me një fjalë që të bëjmë... por nuk ka lidhje me pagesën ose mospagesën. Të paktën kështu e kuptoj unë afatin njëmuor. Në këtë kontekst s’kemi çfarë të diskutojmë më. Unë them që ta votojmë ashtu siç është propozimin për trajtimin financiar që nga data 1 korrik. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Brikena Ukperaj: Mundem pak zoti Rusi!

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj! Po!

Brikena Ukperaj: Nëse ne do të veprojmë kështu, atëherë ne krijojmë një normë në këtë rast dhe norma që ne krijojmë është që magjistrati i cili është kandidat për magistrat në fakt në muajin korrik, përfiton pagë bruto edhe pse nuk ka lindur përgjegjësia jashtëkontraktore e organit. Ligji nuk e parashikon këtë gjë. Gjykatat, në qoftë se do t'u referohemi vendimeve të gjykatave dhe të jemi koherent me to, e kanë parashikuar trajtimin financiar për shkak të mosveprimit të Këshillit. Ne në 30 ditë afat që thotë ligji, brenda një muaji, pra në qoftë se diplomohen në fund të qershorit deri në fund të korrikut, Këshilli është në ushtrim të veprimtarisë së tij dhe të veprimit të tij të ligjshëm. Përgjegjësia fillon nga momenti mbas datës 30 korrik , mbas datës 31 korrik, pra mbas 30 ditëshit, atëherë gjykatat e lidhin mosveprimin administrativ dhe lindjen e përgjegjesisë civile jashtëkontraktore. Në të gjitha vendimet, ky trajtim financiar ka formën e një dëmshpërblimi. Për këtë arsye unë mendoj, për të qenë koherent me gjykatat, me arsyetimet, edhe me ligjin, meqenëse do pranojmë që duhet të bëjmë këtë trajtim financiar dhe fondet i kemi, pagesat fillojnë nga data 1 gusht.

Ilir Rusi: Atëherë, ka diskutime të tjera në vijim?

Përveç asaj çfarë u relatua nga zoti Haxhiu, ka pasur propozime nga zonja Ukperaj, një propozim nga zonja Luli dhe së fundmi propozim nga zoti Hado, që vetëm ka një ndryshim që nuk shprehet “nga data e diplomimit”, por përmendi datën 1 korrik 2023.

Atëherë, i qëndroni propozimeve ju që keni propozuar?

Brikena Ukperaj: Unë i qëndroj propozimit, - se nuk e di si duhet të përgjigjem tani.

Klodian Kurushi: Kam vetëm një ndërhyrje.

Brikena të lutem!

Ilir Rusi: Zoti Kurushi, përshëndetje! Po!

Klodian Kurushi: Përshëndetje!

Më falni, vetëm për sqarim.

Propozimi i zonjës Ukperaj ishte që miratimi i pagesës së trajtimit financiar për magjistratët të fillojë nga data 1 gusht?

Brikena Ukperaj: Po, propozimi im është nga data 1 gusht Klodi, duke menduar që brenda afatit 30-ditor Këshilli është në kompetencat e veta për të ushtruar verifikim dhe ne kemi të drejtën që brenda 30 ditëve të mbarojmë kualifikimet dhe t'i emërojmë. Përgjegjësia fillon mbas kalimit të afatit 30-ditor, dhe për këtë arsye, duke kalkuluar datën e diplomimit që duhet të jetë ndoshta data 27 apo 28 qershor në rastin konkret, me 30 ditë shkon deri në fund të muajit korrik.

Klodian Kurushi: Po, atëherë, faleminderit!

Atëherë, për ta vijuar më tej diskutimin tim. Do ju marrë shumë pak kohë sepse e di që jeni të lodhur dhe mbledhja ka qenë shumë e gjatë dhe vazhdon të jetë e gjatë edhe për momentin.

Unë dakordësohem me propozimin e zonjës Ukperaj për arsyen se, siç e tha edhe zonja Ukperaj dhe nuk dua të kaloj shumë në përsëritje, fillimi i muajit gusht deri në përfundim të muajit gusht, ne si KLGJ vijojmë procesin e parë të kualifikimit apo skualifikimit të kandidatëve dhe për të vijuar më tej, dhënien e statusit, hapjen e vendeve, marrjen e pëlqimit dhe caktimi në pozicion. Janë detyra që ne na i ka ngarkuar ligji për t'i bërë për të gjithë kandidatët për magjistratë.

Tani, pyetja që mua më mbante dhe që nuk i jepja dot shpjegim referuar këtij propozimi, lidhet me faktin nëse neve gjatë kësaj periudhe kemi për detyrë që edhe të skualifikojmë kandidatë, apo jo, e skualifikojmë sepse mund të ketë probleme me pasurinë këto tre vjet, mund të ketë probleme me figurën këto tre vjet, me integritetin, etj., etj., siç na ka ndodhur një rast hipotetik që ne ishim në një situatë nëse do ta merrnim ne masën disiplinore apo duhet ta merrte shkolla. Pra ka një periudhë të ndërmjetme ku kandidati mund të kryejë një sjellje ndoshta të papërshtatshme për shkak të figurës ose

mund t'i konstatohet një pasuri në fund fare e pajustificuar nga ana e tij, që mund të përbëjë shkak për skualifikimin dhe skualifikimi i kandidatit, normalisht në bazë të ligjit për statusin, duhet të jepet nga ana jonë në muajin korrik, pas diplomimit, apo jo? Atëherë, në këtë pikë, a duhet të paguhet? Kjo ishte pyetja ime. A duhet të paguhet kandidati kur neve atë e skualifikojmë? Mendoj se jo. Kandidatët që kualifikohen normalisht fillojnë tek detyrimet e Këshillit pas datës 1 gusht. Pra nga 1 gushti e më tej. Për këtë pjesë unë dakordësohem me zonjën Ukperaj. Sepse deri në fund të muajit korrik ne vijojmë procedurat e detyruara ligjore për kualifikimin/skualifikimin, për dhënien e statusit si magjistrat, për hapjen e vendeve, etj., etj. Kështu që, mbas përfundimit të të gjithë këtij procesi që është kompleks, atëherë ne na lind përgjegjësia, pra pasi i kemi dhënë statusin e magjistratit, ne na lind përgjegjësia që nëse nuk e kemi caktuar në pozicionin përkatës, na lind përgjegjësia për ta trajtuar atë financiarisht sepse nga ai moment, pra nga data 1 gusht, afati i përcaktuar në ligj, na fillon përgjegjësia jonë administrative duke u shkaktuar atyre edhe dëm financiar përkatës. Kështu që në këtë pikë unë mendoj që propozimi i Brikenës është i mbështetur në ligj dhe dakordësohem me këtë propozim. Pra duke shtuar që trajtimi financiar i magjistratëve të fillojë jo nga data e diplomimit por nga data 1 gusht, dita kur ata po themi çlirohen nga detyrimet që kemi ne me ata dhe ata me ne si kandidat dhe ne si Këshill ndaj tyre. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Yllka Rupa: A mund të ndërhyj pak Ilir?

Ilir Rusi: Zonja Rupa?

Yllka Rupa: Po, një sqarim të vogël.

Ilir Rusi: Po, keni ndërhyrje edhe ju. Po!

Yllka Rupa: Për t'i shkuar pak edhe arsytimit të zotit Hado lidhur me trajtimin financiar të magjistratëve. Është një periudhë pauze që i ndërpritet trajtimi financiar 1

muaj, në kuptimin, magjistratët fillojnë trajtohen që nga momenti që hyjnë në Shkollën e Magjistraturës. Pra si do ta justifikojmë këtë periudhën 1-mujore të ndërprerjes së trajtimit financiar? Sepse çështja duhet parë në një kontekst shumë më gjerë se sa kaq.

Brikena Ukperaj: Atëherë Yllka, mundem?

Yllka Rupa: Po, po!

Ilir Rusi: Po zonja Ukperaj, fjala për ju!

Brikena Ukperaj: Gjatë tre viteve të shkollës, magjistratët marrin bursë.

Yllka Rupa: Po, e kam të qartë këtë.

Brikena Ukperaj: Kjo bursë përfundon në momentin kur ata diplomohen.

Aty shkolla ndërpret çdo marrëdhënie. Aty fillon detyrimi i Këshillit që brenda një muaji të vendosë kualifikim/skualifikim, dhe emërim, siç thotë neni 35 i ligjit. Ligji këtë periudhë nuk e lidh me ndonjë trajtim financiar. Nuk parashikon që merr trajtim financiar. Dakord? Tani, ky lloj trajtimi financiar që ne po miratojmë sot ka formën e një dëmshpërblimi dhe që ne të pranojmë krijimin e një dëmi, pra lindjen e një përgjegjësie për ne, duhet të kemi kryer një veprim, të themi, jo në përputhje me ligjin, ose të mos e kemi respektuar afatin 30-ditor të parashikuar në ligj, dhe ky mosrespektim fillon nga data 1 gusht. Nuk dua të përsëris ato që tha zoti Kurushi. Në këtë periudhë njëmuajore nuk ka trajtim financiar, as ligji por edhe as ne nuk mund t'ia u japim sepse nuk kemi një shkak ligjor që t'ua japim, nuk kemi një bazë ligjore që t'ia u japim këtë trajtim financiar. Ne po pranojmë që, po, ne kemi zgjatur procedurat e emërimit, për arsyet që lidhen me situatën në sistem, çka ka sjellë lindjen e një përgjegjësie. Po kur na ka lindur kjo përgjegjësi? Na ka lindur mbas kalimit të afatit 30-ditor. Nuk parashikohet vijueshmëria e trajtimit. Nëse do ishte parashikuar, atëherë po, jam dakord në qoftë se do të kishte një dispozitë ligjore që ne do ta kishim të mbështetur Dhe këtë mënyrë interpretimi e kanë bërë gjykatat në vendimet e tyre.

Kam edhe një diskutim tjetër. Kjo është një çështje “pikante” për arsye sepse gjykatat më të larta në fakt nuk janë shprehur. Ne po pranojmë arsyetimin e gjykatave të shkallës së parë, vendimet e të cilave janë bërë të ekzekutueshme tashmë sepse janë dhënë me ekzekutim të përkohshëm dhe magjistratët janë paguar.

Ilir Rusi: Atëherë, zonja Ukperaj, jo vetëm ju por të gjithëve ju falënderoj për ndërhyrjet. Natyrisht që është çështje sionisteve në raport me faktin që është pagë natyrisht por njeriu zgjedh një profesion dhe punon për pagën dhe prandaj ka edhe këto diskutime.

Tashmë, do doja si drejtues i seancës të përmbledhja propozimet tuaja, se sa të bëja një koment mbi to.

Zonja Luli, meqenëse është prezent në sallë, ka kohë që do të bëjë një ndërhyrje.

Po, zonja Luli!

Fatmira Luli: Po bëj një përmbledhje, bashkimin e dy propozimeve. Datën 1 gusht po e lidh me datën e emërimit. Të fillojë pagesa nga data e emërimit që është data 1 gusht i çdo viti ose nga data 1 gusht, në kllapa (data e emërimit të tyre), që të kuptohet që ka të bëjë me procesin e emërimit.

Brikena Ukperaj: Fatmira, nuk ka ndodhur në 1 gusht emërimi.

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Emërimi nuk ka ndodhur në 1 gusht. Duhet të ndodhte para 1 gushtit (brenda muajit korrik). Nuk ka ndodhur. Në fakt emërimi i magjistratëve sivjet është bërë në muajin tetor dhe nuk mund ta lidhim me emërimin. Duhet ta lidhim me datë të saktë.

Ilir Rusi: Po, e kuptova, domethënë, duke qenë se jeni propozuesja e parë, nuk gjen vend ky propozim i zonjës Luli tek propozimi juaj dhe qëndron që propozimi i zonjës Luli të jetë propozim më vete.

Brikena Ukperaj: Po!

Ilir Rusi: Tani, meqenëse ka pasur disa propozime, dhe në parashtrësat e zotit Kurushi u bashkua me propozimin tuaj, deri në këtë moment jemi që zonja Ukperaj së bashku me zotin Kurushi kanë një propozim, zonja Luli ka një propozim të dytë në kronologji dhe zoti Hado ka një propozim pothuajse të njëjtë me relatorin por vuri një datë përkatëse, 1 marsin 2023 (*korrigjohet nga zoti Rusi*), 1 korrik 2023, kërkoj ndjesë, 1 korrik 2023, ndërsa në aktin e përcjellë nga komisioni është “nga data e diplomimit deri në momentin e caktimit në pozicion”. Atëherë, ka propozime të tjera?

Nuk ka propozime të tjera.

Me kronologji, meqenëse propozimi i zonjës Ukperaj dhe i zotit Kurushi është i njëjtë, atëherë po e hedhim fillimisht në votim propozimin (bërë fillimisht nga zonja Ukperaj por meqenëse dhe zoti Kurushi ka të njëjtin propozim), propozimin e tyre.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Kundër.

(6 (gjashtë) vota kundër dhe 2 (dy) vota pro. Nuk miratohet.)

Ilir Rusi: Në kronologji do hidhet në votim propozimi i zonjës Luli e cila po ndërhyr për ta perifrazuar/saktësuar propozimin e vet. Po, fjala për ju zonja Luli!

Fatmira Luli: Duke pasur parasysh që ky vendim i Këshillit mund të shërbejë gjithmonë si një akt që do të përdoret edhe nga kandidatët për magistratë në vitet e ardhshme, unë e lidh gjithmonë momentin që duhet të fillojë pagesa me momentin e fitimit të statusit të gjyqtarit. Në momentin që ai është kandidat, nuk ka dhe nuk krijon

dot raporte punësimi, shpërblimi me pagë nga Këshilli dhe nga gjykatat. Kjo marrëdhënie fillon nga momenti që ai emërohet dhe ky emërim në këto vite ndoshta, duke qenë që ka pas numër të madh kandidatësh, ka dashur kohë më shumë se një muaj, por në vitet e ardhshme kur të jetë 5, 6, 10, mund të bëhet më pak se një muaj, atëherë duhet lidhur gjithmonë me momentin e emërimit të tij, që nga momenti i emërimit i fillojnë detyrimet dhe të drejtat nga Këshilli dhe nga gjykata. Prandaj propozoj që të lidhet pagesa me momentin e emërimit dhe për kandidatët në rastin konkret, përjashtimisht të fillojë nga 1 gushti, meqenëse ne jemi në vonesë për pagesën e tyre, kemi kaluar afatin njëmuajor të detyrimit që ne kemi si Këshill.

Ilir Rusi: Zonja Luli ju falënderoj për saktësimin e propozimit tuaj.

Vazhdojmë me votimin e propozimit të zonjës Luli.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër sepse kjo që thotë Fatmira është e parashikuar në ligj. S'kam çfarë votoj.

Ilir Rusi: Zonja Rupa!

Yllka Rupa: Pro.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Atëherë, unë shoh që propozimi i zonjës Luli përputhet me atë propozim që thashë edhe unë më përpara. Sa kohë propozimi i zonjës Luli përmend si element të saj fillimin e trajtimit financiar të kandidatëve për magistratë datën 1 gusht, atëherë kjo nuk është në kundërshtim me atë çfarë thashë unë, kështu që në këtë pikë unë dakordësohem me propozimin e zonjës Luli. Faleminderit!

Ilir Rusi: Kundër.

(5 (pesë) vota kundër dhe 3 (tre) vota pro. Nuk miratohet.)

Ilir Rusi: Tashmë kalojmë për kronologji tek z. Hado i cili ka bërë një propozim

por edhe zoti Hado kërkon një saktësim të propozimit të vetë duke marrë në konsideratë edhe lapsusin që unë bëra përgjatë parashtresës duke përmendur muajin maj. Saktësoje zoti Hado!

Ridvan Hado: Propozova datën 1 korrik për trajtimin financiar të magjistratëve të rinj, viti 2023, për arsyen e thjeshtë pasi ato marrin trajtim financiar nga Shkolla e Magjistraturës deri në datën 30 qershor. Muaji qershor është i ezauruar nga Shkolla e Magjistraturës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Atëherë, kalojmë në votimin tashmë të propozimit të saktësuar të zotit Hado, duke tejkaluar edhe lapsuset.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundra.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e zotit Hado.

(5 (pesë) vota pro dhe 3 (tre) vota kundër. Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Atëherë, deri tani u miratua propozimi në lidhje me momentin kohor se kur fillon ky trajtim financiar. Por ndërkohë që zonja Ukperaj, në fillim të saj ka bërë një propozim mbi ndryshimin e titullit, e cila do të reflektohet në rast miratimi dhe në përmbajtjen e aktit, duke u zëvendësuar shprehja “mbi pagesën e trajtimit financiar” me shprehjen “mbi trajtimin financiar të magjistratëve, profili gjyqtar, të diplomuar në vitin akademik 2022-2023”, dhe në pikën 1 “Miratimin e pagesës së trajtimit financiar”, propozohet “Trajtimin financiar të magjistratëve, profili gjyqtar, të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023” - për korrektesë po e lexoj sipas propozimit të miratuar tashmë, të zotit Hado - “nga 1 korriku i vitit 2023”.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Unë jam dakord me ndryshimin e formulimit por prapë vendimi mbetet i papërcaktuar sepse nuk përcakton mbi bazën e kujt do të bëhet ky trajtim financiar (pagë bruto, pagë neto, etj., et.).

Klodian Kurushi: Dakord.

Dakord me këtë propozim të ndryshuar, pra të hiqet fjala “pagesë”. Jam dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet unanim.)

Ilir Rusi: Atëherë, tashmë votojmë këtë akt, duke reflektuar edhe këto ndryshimet përkatëse në tërësi të tij.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord me ndryshimin e emërimit dhe në përmbajtjen të pagesës, por jam kundër me kohën kur fillon kjo pagesë.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër me aktin.

Klodian Kurushi: Dakord pjesërisht me aktin për arsyet që thashë më lart.

Ilir Rusi: Dakord në tërësi të aktit.

(Miratohet akti me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Vendim “Mbi trajtimin financiar të magistratëve, profili gjyqtarë, të diplomuar në vitin akademik 2022-2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Trajtimin financiar të magistratëve (profili gjyqtarë), të diplomuar nga Shkolla e Magistraturës në vitin akademik 2022-2023, nga 1 korrik 2023.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe gjykatat respektive.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Efektet e këtij akti i cili sapo u miratua fillojnë nga 1 korriku i vitit 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës”/ “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)*
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)*
8. ***Yllka Rupa*** (anëtare)*

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4 sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 8.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte EWMI.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës”/ “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me një pikë tjetër, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës”/ “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 659, datë 02.11.2023 është vendosur: “Hapja e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpallja e kërkesës për kandidaturë, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”. Si “deadline” është lënë data 17 nëntor.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm një kërkesë. Kjo kërkesë i përket zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës për pozicionin “Pedagog i brendshëm, me drejtim formimin vazhdues.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në këtë rast përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe person nëse komandimi është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin (ky fakt bazuar në vendimin 659, 02.11.2023 të KLGJ-së, ku në kreun e dytë të tij është përcaktuar edhe procedura e hollësishme që ndiqet në këtë rast.)

Në këtë kuadër janë marrë në analizë të gjitha kushtet dhe kriteret për këtë komandim.

Në lidhje me kushtet ndaluese të komandimit, ato përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në pikën 3, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 40, datë 27.01.2023 janë përcaktuar me detaje kushtet e komandimit të cilat janë si më poshtë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në analizë të kushteve/kritereve të mësipërme, është administruar dosja personale

e gjyqtares, nga e cila rezulton:

Zonja {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Juriste, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrrojë detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 10 vite.

Znj. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kusht ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës.

Sa i përket cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga zëvendëskryetari në detyrë i gjykatës respektive, rezulton se:

“...Me anë të email Tuaj të datës 21.11.2023 është bërë me dije se KLGJ me vendimin nr. 659, datë 02.11.2023 ka vendosur të hap procedurën e komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Brenda afatit të kandidimit, ka aplikuar znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Bazuar, në nenin 54 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" është kërkuar opinion nga Zv/Kryetari i Gjykatës, në rastin hipotetik të komandimit të gjyqtares në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin “Pedagog i brendshëm” nëse ka apo jo cenim të interesave të larta të kësaj gjykate në drejtim të funksionalitetit të saj. Në lidhje me sa më sipër, sqaroj sa vijon:

Me implementimin e hartës së re gjyqësore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka të përcaktuar në organikë 23 (njëzetë e tre) gjyqtarë. Aktualisht, në këtë gjykatë ushtrojnë detyrën 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë, përfshirë edhe Zv/Kryetarin e gjykatës. Me vendimin nr. {...} prot, datë 23.10.2023, Zv/Kryetari i Gjykatës ka vendosur të përjashtojë nga shorti gjyqtaren Znj. ({...}), për

shkak të gjendjes shëndetësore të saj, shtatzënë, pasi në fund të muajit Nëntor 2023 llogaritet të marrë lejen e lindjes. Ndërkohë, me vendimin nr. {...} prot, datë 06.11.2023, Zv/Kryetari i Gjykatës ka vendosur përjashtimin nga shorti të gjyqtarit Z. {...}, për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i KLGJ-së, mandat të cilin pritet ta filloj në datë 12.12.2023. Gjyqtari më parë, me vendimin nr. 170, datë 12.10.2023 është përjashtuar nga shorti.

Sa më sipër, konstatohet se aktualisht në këtë gjykatë shortohen rregullisht vetëm 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë, të ndarë në dy seksione, penale dhe civile.

Është fakt i ditur se gjykata vijon të përballoj ngarkesë të madhe, një pjesë e së cilës është e trashëguar më parë, ndërkohë që numri i gjyqtarëve është akoma i ulët.

Në cilësinë e Zv/Kryetarit të gjykatës, vlerësoj se gjyqtarja znj. {...} ({...}) i ka aftësitë e duhura për të qenë pjesë e stafit të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, si pedagoge e brendshme dhe opinionin i Zv/Kryetarit të Gjykatës në këtë rast është për miratimin e kërkesës së saj. Gjithsesi, ky opinion mbetet i kondicionuar nga situata aktuale në të cilën ndodhet gjyqtarja dhe në pritshmërinë që në vijim dhe në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli i Lartë Gjyqësor të emërojë/transferojë gjyqtarë në këtë gjykatë.”

Këshilli ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, si lëvizja paralele dhe transferimi i përkohshëm (vendimet nr. 21-24 dhe 31-32 datë 18.01.2023). Është për t’u vlerësuar se ngarkesa aktuale e çështjeve që ka kjo gjykatë në raport me numrin aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate paraqitet në tabelën bashkëlidhur.

Kjo situatë, nëse cenohen interesat e lartë të gjykatës për shkak se cenohet funksionaliteti i saj, vlerësohet përballë opinionit të përcjellë nga zv/kryetari i gjykatës respektive për këtë çështje.

Kriteret e komandimit përveç atij specifik të mësimdhënies.

Në Kreun II, pika 8 të vendimit 659, datë 02.11.2023, është parashikuar se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjellë Shkollës së Magjistraturës emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

Kriteret e komandimit për pozicionin “Pedagog i brendshëm”, janë:

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës,

mbi dhjetë vjet; ose

b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e pedagogut të brendshëm janë përcaktuar në nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ku parashikohet eksperiencia mbi 10 vjet.

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, rezulton se znj. {...} është caktuar përkohësisht në detyrë në 21.10.2013, pra ka vjetërsi në detyrë 10 vjet, kriter i cili përmbushet nga kandidatja.

Lidhur me kriteret e tjera specifike: rezulton se ka kaluar Vetting-un;

Për sa më sipër, Komisioni ju propozon në mënyrë alternative:

Përfundimisht e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme apo dërgimi i emrit të saj Shkollës së Magjistraturës, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej saj.

Ky është pak a shumë relacioni i përgatitur i cili shoqërohet nga dy projekt-akte, përkatësisht përjashtimi nëse Këshilli do ta vlerësojë si të tillë apo dërgimi i emrit të saj për të vijuar më tej pastaj për t’u vlerësuar kriteri i mësimdhënies dhe kriteri shtesë për pozicionin përkatës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

Ju lutem, a ka diskutime për sa u parashtrua nga zoti Toro?

Brikena Ukperaj: Alban, kemi një propozim konkret?

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Alban Toro: Brikena, ashtu siç edhe parashtrova, është lënë për diskutim Këshillit për shkak të karakterit të veçantë që ka çështja. Nëse do të dish opinionin e Albanit,

Albani është për përjashtimin e saj sepse aktualisht, fillojmë nga gjendja fizike e cila nuk është se mund të ofrojë shërbim pranë Shkollës së Magjistraturës. Aktualisht duhet të ketë marrë lejen e lindjes, për efekt të gjendjes shëndetësore. Së dyti, me ç’rezulton Gjykata e Rrethit Durrës, përveç faktit që është një gjykatë në nevojë, por çështjet në ngarkim të gjyqtarës që kanë qenë dikur rreth 400 me secilin nga gjyqtarët prezent në të, ka një ngarkesë relativisht të madhe në këtë gjykatë, përveç faktit që është një gjykatë me një trup gjyqësor të limituar, në raport me strukturën organizative të miratuar. Kështu që nëse doni të dini opinionin e Albanit, ai është për refuzim.

Brikena Ukperaj: Ideja ime është për faktin sepse... Zonja {...} është larguar tashmë me leje barrë lindjeje ose mund të marri për pak ditë lejen e barrë lindjes? – diçka e tillë?

Alban Toro: Kryetari, në opinionin e vet është shprehur që në nëntor të 2023 ka marrë lejen. Ka përfituar lejen e lindjes.

Brikena Ukperaj: Pra ne funksionalitetin e shikojmë afatgjatë sepse sot aktualisht, tashmë ajo është larguar. Domethënë nuk vihet në diskutim aktualisht funksionaliteti.

Alban Toro: Përpos kësaj, unë e vlerësoj edhe nga fakti që duke përfituar lejen, të paktën maksimalja e të cilës është 1 vit, unë nuk e di sa do t’i shërbejë Shkollës së Magjistraturës kjo magjistrate në këtë gjendje shëndetësore që ajo ndodhet. Nëse pastaj pas lindjes do të vendosi të rikthehet për të ushtruar funksionin e gjyqtarit apo të rivlerësojë edhe një herë pozicionin e saj për t’iu drejtuar si pedagoge e Shkollës së Magjistraturës, pastaj le t’i drejtohet. Por për momentin ajo është e pamundur të ushtrojë asnjë nga funksionet që kërkohen.

Brikena Ukperaj: Ajo që unë shtroj për diskutim është: Cili është roli i Këshillit në këtë moment dhe çfarë kompetencash ka Këshilli? Këshilli në këtë moment duhet të shqyrtojë nëse komandimi i zonjës {...} e dëmton apo jo funksionalitetin e gjykatës, apo

jo? Pra ne bëjmë një opinion nëse komandimi i zonjës {...} apo i kujtdo gjyqtari, dëmton apo jo funksionalitetin e gjykatës. Nëse do ta vlerësojmë në këtë moment, zonja {...} është e larguar tashmë nga gjykata me leje barrë lindje. Pra nuk mund të diskutohet më për funksionalitet për komandim sepse për shkak të një të drejte kushtetuese ajo tashmë është e larguar nga gjykata me leje barrë lindje. Nëse do ta shikojmë në afatgjatë pastaj, për aq kohë sa zgjat komandimi, kjo është diçka tjetër.

Alban Toro: Briken, unë mendoj që duhet vlerësuar edhe fakti i ushtrimit efektiv, pra ajo që na kërkohet nga shkolla është që ne të identifikojmë, në përputhje me kërkesat që do na vijnë, që kemi të administruar, të identifikojmë një gjyqtar i cili do të mund të ushtrojë funksionin e pedagogut të brendshëm, kuptohet, pa prishur funksionalitetin. Në rastin konkret bie kjo skemë sepse gjyqtarja në fjalë që është vetë ofruar në momentin aktual është me leje lindje. Nuk e di çfarë duhet të bëjë shkolla, pra çfarë përfitimi ka shkolla nga ky ofrim shërbimi? Del pa vlerë çdo gjë.

Brikena Ukperaj: Megjithatë, unë mendoj që kjo gjë i takon shkollës. Nëse shkolla do të vlerësojë që po, ky gjyqtar plotëson kriteret për t'u komanduar sepse ne bëjmë thjesht verifikimin e kushteve ligjore dhe kushtet ligjore, me sa përmende në relacion, tashmë zonja {...} e cila ka kandiduar disa herë për komandim, i plotëson. Po kështu, nëse do të diskutojmë për funksionalitetin e gjykatës, funksionaliteti i gjykatës sot në këtë moment nuk dëmtohet nga komandimi sepse zonja {...} është tashmë e larguar nga gjykata me leje barrë lindje. Nëse shkolla pastaj do të pranojë komandimin e kësaj gjyqtareje, sepse është faza e dytë që e vendos shkolla, ky është pastaj vlerësim i shkollës, nuk mund ta bëjë dot Këshilli. Se zonja {...} mundet të thotë, po, unë u largova me leje barrë lindje, nuk do ta kryej lejen e lindjes dhe unë do kthehem të kontribuojë në Shkollën e Magjistraturës. Kjo është gjë që i takon shkollës. Nëse do ta vlerësojmë në afatgjatë komandimin pastaj, kjo është diçka tjetër sepse gjatë kësaj kohe ne mund të mbushim edhe vakancat e Gjykatës së Durrësit.

Dhe duke pasur parasysh edhe diçka tjetër, ka tre herë që shkolla hap procedura dhe kërkon komandim gjyqtari dhe ne nuk kemi asnjë kandidat tjetër.

Alban Toro: Unë nuk besoj që interesi publik i yni për t'u mbrojtur është të furnizojmë shkollën me pedagogë, për sa kohë që ne kemi gjykatat në gjendje të mjerueshme për sa i përket burimeve njerëzore. Ne jemi që kemi shpallur Gjykatën e Durrësit si gjykatë në nevojë dhe kemi aplikuar skemën e transferimit të përkohshëm në të. Kështu që për sa kohë ekziston kjo situatë e nderë pranë asaj gjykate, do të na bënte nder që nëse kthehej përpara afatit të përcaktuar nga ligji për konsumimin e lejes së lindjes, do të ishte më me vlerë (duke vlerësuar edhe interesin publik), që ajo të ishte e integruar në trupën gjyqësore të Durrësit. Unë të paktën kështu e vlerësoj interesin publik për momentin.

Brikena Ukperaj: Alban, nuk do të hiqja asnjë presje nga diskutimi nëse zonja {...} do ishte në detyrë sot. Por në kushtet kur ajo ka ikur dhe çështjet e saj duhet të jenë rishpërndarë mes gjyqtarëve, nuk bëhet fjalë më për cenim funksionaliteti për shkak të komandimit. Këtu e kam gjithë diskutimin.

Ilir Rusi: Ka ndonjë propozim të dytë, sepse zoti Toro e shprehu propozimin e vet, ka ndonjë propozim të dytë apo ndonjë diskutim tjetër?

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Atëherë, unë jam për propozimin që t'i dërgohet shkollës emri i zonjës {...} për të aplikuar si e komanduar në shkollë, me qëllim vlerësimin e kriterit të mësimdhënies dhe kriterëve të tjera në pozicionin përkatës. Faleminderit!

Yllka Rupa: Zoti Rusi, mund të ndërhyj pak?

Ilir Rusi: Po, zonja Rupa!

Yllka Rupa: Ne kemi pas edhe raste të tjera të komandimit dhe jemi mjaftuar me opinionin e gjykatës lidhur me cenimin e funksionalitetit. Kështu që edhe në rastin konkret nuk e shoh si një element pengues. Kështu që unë dakordësohem me propozimin

e zotit Hallunaj.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime apo propozime të tjera?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Atëherë kemi në përmbajtje dy propozime të bërë nga disa anëtarë. Kemi një propozim të bërë nga zoti Toro dhe një propozim nga zoti Hallunaj i cili është mbështetur nga zonja Rupa.

Fillimisht hedhim në votim propozimin e parë të bërë në kronologji nga zoti Toro, i cili kërkon përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si pedagoge e brendshme pranë Shkollës së Magjistraturës për shkak se cenon interesat e larta të gjykatës për shkak se cenohet funksionaliteti i saj.

Dritan Hallunaj: Unë jam kundër. Pra jam pro që t'i dërgohet shkollës. Faleminderit!

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Kundër. T'i dërgohet shkollës, meqenëse shkolla vetë ka kërkuar dhe i njuh kushtet e kandidatës.

Yllka Rupa: Kundër propozimit të zotit Toro.

Brikena Ukperaj: Kundër propozimit të zotit Toro.

Klodian Kurushi: Pro propozimit të zotit Toro.

Ilir Rusi: Kundër propozimit të zotit Toro.

(6 (gjashtë) vota kundër dhe 2 (dy) vota pro. Nuk miratohet propozimi i zotit Toro.)

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse dy ishin alternativat. Njëra kishte të bënte me përjashtimin dhe tjetra kishte të bënte që t'i dërgohet Shkollës së Magjistraturës. Meqenëse përjashtimi për të përjashtuar emrin nuk u miratua me votë, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit i cili ka të bëjë me aktin "Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "pedagog i brendshëm" në Shkollën e Magjistraturës".

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Pro.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Pro dërgimit të emrit.

Vendim “Për dërgimin e emrit të kandidatës e cila ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës”.

Këshilli i Lartë i Gjqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. T’i dërgohet Shkollës së Magjistraturës emri i znj. {...}, e cili ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej saj, me qëllim vlerësimin e kriterit të mësimdhënies dhe kriterëve shtesë për pozicionin përkatës.

2. Publikimin e këtij opiniononi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)*
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 5. Ridvan Hado** (anëtar)
- 6. Alban Toro** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj** (anëtare)*

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6 sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 8.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me një pikë tjetër të shqyrtimit të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur

relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët nga ana e Këshillit, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Dibër janë të administruara kërkesa për caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, ndërkohë nga e po Këshillit janë emëruar trupa e re gjyqësore e cila ka përfunduar studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, duke plotësuar një sërë vakancash pranë kësaj gjykate dhe duke bërë tashmë të panevojshëm caktimin e gjyqtarëve nga gjykata të tjera të cilët nuk kanë funksion të përhershëm pranë kësaj gjykate.

Për rrjedhim, kërkesat e depozituara tashmë kanë mbetur pa objekt, pasi për këto kërkesa do të gjenden zgjidhjet për shkak të plotësimit të këtyre vakancave dhe transferimit të këtyre çështjeve pranë gjyqtarëve të rinj.

Pra kur verifikohen këto kushte, është një parashikim nga neni 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit gjejnë zbatim edhe në rastin e Këshillit, apo për situatat që kërkohet aktualisht dhe që nuk janë parashikuar shprehimisht nga ligji 115/2016, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Për rrjedhim është përgatitur projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

i. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 175, 166, 3, 114, 200 të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër

ii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës:

Nr. 774 të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarëve të gjykatave të sipërcituara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Nuk ka diskutime.

Atëherë, kjo pauzë tregon që nuk ka diskutime. Vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë dhe Dibër për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

i. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të

kërkesave:

Nr. 175, 166, 3, 114, 200 të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër

ii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës:

Nr. 774 të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarëve të gjykatave të sipërcituara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.12.2023)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.⁷

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:26 dhe mbaroi në orën 17:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar)* |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare)* |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare)* |

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7 sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 8.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, po vazhdojmë me pikën e fundit të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacionet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Fjala relatorit z. Toro.

Alban Toro: Relacioni i parë i parashtruar është “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, kërkesa e të cilës është administruar më datë 05.12.2023, pranë KLGJ-së, e cila bën fjalë për gjykimin e një çështjeje penale me objekt: “Ndreqje gabimi material”. Ndër të tjera, kjo çështje është trashëguar nga gjykata e rrethit gjyqësor Pukë dhe ka pasur kryesues gjyqtarin {...} dhe

është plotësuar nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Në këtë vendim është konstatuar gabimi material nga vetë gjyqtari kryesues z. {...}. Fakti që ky gjyqtari nuk ushtron më detyrën në këtë gjykatë, gjë që ka bërë që gjykata kërkuese të paraqesë këtë kërkesë në Këshill.

Shkurtimisht parashtrohet se: Në vijim gjyqtari {...} dhe trupa gjyqësore e përcaktuar për përfundimin e kësaj çështje ka disponuar me vendim nr. {...}, datë 03.10.2023.

Nga ana e Gjyqtarit {...} është konstatuar kryesisht gabim material në vendimin nr. {...}, datë 03.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, konstatim të cilin e ka përcjellë pranë kësaj gjykate përmes kërkesës nr. {...} prot, datë 23.10.2023, me objekt: Nenet 114 të Kodit të Procedurës penale i cili përcakton: Ndreqja e vendimeve dhe e urdhrave me gabime materiale bëhet edhe kryesisht nga gjykata që ka nxjerrë aktin. Kur ndaj këtij akti bëhet ankim, i cili pranohet, ndreqja bëhet me vendim të gjykatës që shqyrton ankimin, në bazë të të cilit bëhet shënim në origjinalin e aktit.

Si dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 385 të Kodit të Procedurës Penale:

“ 1. Gjykata, edhe kryesisht, procedon për ndreqjen e vendimit kur duhet korrigjuar ndonjë gabim material.”

Në këto kushte është përgatitur projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: Kryesisht gjyqtari kryesues; Objekti: Ndreqje gabimi material.

(Zoti Toro vijon të lexojë edhe propozimin e dytë në projektvendim lidhur me relacionin e dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” në të cilin ndër të tjera bëhet fjalë për kërkesën që kjo gjykatë ka bërë pranë KLGJ-së për një çështje penale, me nr. kërkesë {...} dhe numër çështje 105., në të cilën kërkon një gjyqtar.)

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal (seancë paraprake).

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkesë: Kryesisht gjyqtari kryesues; Objekti: Ndreqe gabimi material.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal (seancë paraprake).

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, si pikë të fundit të saj.

Duke ju uruar një mbrëmje të qetë.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor